



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“ZONA EKONOMIKE” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Zona ekonomike” në kuadër të PSZHUP-së, që përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit në kuadër të Planit strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, i emërtuar si “Zona ekonomike”, e cila përkufizohet: nga ana veriore me Gazimestanin, në anën verilindore me “Unazën e jashtme” dhe rrugën e varrezave, në anën lindore me “Arbërinë 3”; kalon rrugën Prishtinë- Mitrovicë dhe kufizohet me zonën e TMK-së deri te hekurudha, pastaj, me pjesën perëndimore duke u kufizuar me rezervuarin e ujit dhe prapë targon rr. Prishtinë - Mitrovicë, kufizohet me fsh. Shkabaj, duke vazhduar me Fshatin e Ri të Hadës, në sipërfaqe prej 620 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës, nga par.1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që t’i sigurojnë dhe dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat konsiderohen të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr.35-1017, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa